Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>		<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>		
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)		
1	Blerje program (software) për kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele, si dhe analiza e flukseve të fuqisë për rrjetin e transmetimit - sipas specifikimeve teknike	komplet	1				
2	Numri minimal i Licensave aktive	komplet	3				
3	Sasia minimale e çelësve të licencës ose USBve (dongle) për aktivizimin e programit	copë	3				
4	Mirëmbajtja e softuerit	komplet	1				
5	Trajnimi bazë minimalisht për tre përdorues	komplet	1				
6	Database e Releve	komplet	1				
					Çmimi total (Mallrat)		_____
Çmimi Neto pa TVSH							
TVSH (%)							
Çmimi total me TVSH:							
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit							
Nënshkrimi							
Vula							
Datë _____							

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

HYRJE DHE SFONDI KRYESOR

Specifikime tekniket e paraqitura në këtë dokument përcaktojnë kërkesat minimale dhe kushtet e tjera të nevojshme për prokurimin e një softueri për mbrojtjen e sistemit elektroenergjetik për selektivitetin e koordinimin releve për rrjetin e transmetimit të energjisë.

Mbrojtja e rrjetit është elementi kyç për të zbutur rreziqet në një sistem energjie të ndërlidhur dhe për të rritur besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike duke kontribuar në elasticitetin e vetë sistemit. Modelimi i duhur i pajisjeve mbrojtëse është një detyrë thelbësore për inxhinierin e sistemit elektroenergjetik.

Rrjeti i Transmetimit administrohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të OST sh.a, i cili është i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së ligjshme të transmetimit të energjisë elektrike nëpërmjet rrjetit të tensionit të lartë (110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV).

Asetet e administruara nga OST sh.a janë:

- Të gjithë linjat elektrike ajrore dhe nëntokësore me tension 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV përfshirë pajisjet dhe instalimet komutuese të tyre.
- N/Stacionet 400/220/110 kV; 400/220 kV; 400/110 kV; 220/110/TM kV; 220/TM kV dhe zbarat e nënstacioneve 110/TM të Operatorit të Shpërndarjes, deri tek pika e matjes së energjisë elektrike në anën 110 kV të transformatorëve të fuqisë 110/TM të nënstacioneve të Operatorit të Shpërndarjes.
- N/Stacionet 220 kV të hidrocentraleve V.Dejes, Koman dhe Fierze, përveç daljeve 220 kV të gjeneratorëve deri tek thikat e zbarave 220 KV, traktin 110 kV/150 kV përfshirë daljen 150 kV të linjës ajrore 150 kV dhe transformatorin ngritës të fuqisë 110/150 kV në N/Stacionin e Hidrocentralit Bistrica 1.

Rrjeti i transmetimit i Shqipërisë funksionon duke ruajtur dhe përmirësuar vazhdimisht performancën e tij, veçanërisht në drejtim të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit për të gjithë klientët e tij. Mbetet detyrë e përhershme e operatorit të këtij Sistemi të planifikojë dhe zbatojë masa në terma të ndryshëm kohorë, për të përmirësuar gjendjen e tij drejt ruajtjes dhe arritjes së mëtejshme të standardeve. Gjithashtu, OST është anëtare me të drejta të plota në ENTSO-E (Shoqata Evropiane Për Bashkëpunimin E Operatorëve Të Sistemit Të Transmetimit (OSTve) Për Energjinë Elektrike), që nga viti 2017 dhe ka detyrimin të përmbushë rregullat dhe standardet që përmban kjo organizatë dhe harmonizimin e kuadri ligjor të Bashkimit Europian në fushën e energjisë.

Në këtë kuadër, mbetet shumë punë për t'u bërë në drejtime të ndryshme në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, për të siguruar ndërhyrjet e duhura, të cilat do të çojnë në përmirësimet e nevojshme në të gjithë elementët e rrjetit.

Një nga drejtimet e nevojshme dhe aktuale në të cilën është e nevojshme të ndërhyhet është nevoja për përmirësime të caktuara, por akute në sistemin e mbrojtjes rele.

OST është përgjegjëse për instalimin e mbrojtjes rele në të gjithë Rrjetin e Sistemit të Transmetimit 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV. OST miraton sistemin e mbrojtjes rele dhe vendos cilësimet në

elementët e rrjetit në koordinim me përdoruesit e rrjetit të transmetimit. Përdoruesit e rrjetit të transmetimit prej tyre, janë përgjegjës për tarimet e mbrojtjes rele të rrjetit, sistemeve/objekteve të tyre dhe do të koordinojnë tarimet e Mbrojtjes Rele në këto instalime dhe pajisje në kufirin e pronës me Rrjetin e Sistemit të Transmetimit.

Një sistem elektrik i besueshëm kërkon mbrojtjen e duhur dhe koordinimin e kontrollit ndërmjet termocentraleve dhe sistemit të transmetimit.

Koordinimi i sistemeve të mbrojtjes së gjenerimit dhe transmetimit (për ngjarjet e jashtme të termocentralit), do të thotë që mbrojtja e ocentralit dhe elementët përkatës të kontrollit duhet të vendosen dhe konfigurohen për të parandaluar aktivizimet e panevojshme të gjeneratorit përpara se çdo mbrojtje transmetimi dhe sisteme kontrolli të lidhura të veprojnë së pari, përveç nëse gjeneratori është në rrezik duke tejkaluar kufijtë e tij të projektuar për shkak të kushteve të funksionimit, defekteve të sistemit të gjeneratorit ose kushteve të tjera të pafavorshme potencialisht të dëmshme.

OST-ja mund të këshillojë modifikime dhe përmirësime të mbrojtjes rele në sistemin e shpërndarjes, për të reduktuar ndikimet negative në sistemin e transmetimit.

Nevoja për të kryer një studim gjithëpërfshirës të koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes për rrjetin 110kV, 220kV dhe 400kV, duke përfshirë të gjitha nënstacionet dhe linjat përbërëse, si dhe propozimet për mundësinë e përmirësimit të sistemit të mbrojtjes rele është një detyrë e nevojshme.

Qëllimi i analizës së koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes në rrjetin e tensionit të lartë, në mënyrë që pajisjet mbrojtëse të izolojnë dhe eliminojnë defektin shpejt dhe në mënyrë selektive.

Koordinimi i mbrojtjes nënkupton zgjedhjen dhe vendosjen e pajisjeve mbrojtëse në mënyrë që ato të jenë mjaft të ndjeshme për të funksionuar kur është e nevojshme, dhe mjaft selektive për të mos operuar, ose për të ofruar diferencë të mjaftueshme, kur nuk është e nevojshme.

Studimi i koordinimit të mbrojtjes ose vlerësimi i sigurisë duhet të marrë në konsideratë topologjinë e rrjetit, elementët e rrjetit, kushtet e ndryshme të funksionimit, praktikat e shërbimeve dhe kërkesat rregullatore.

Sipas strategjisë kombëtare të energjisë 2018-2030 të vendit, Shqipëria ka vendosur objektiva për efikasitetin e energjisë si reduktimi i gazeve serrë, diversifikimi i burimeve të rinovueshme, rritja e depërtimit të gazit natyror, etj.

Në kuadër të politikës së diversifikimit të energjisë elektrike në vend, veçanërisht vitet e fundit, ka pasur një numër të madh kërkesash për lidhjen e burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE) në rrjetin e transmetimit. Kryesisht këto janë centrale diellore dhe të erës. Depërtimi i energjisë së rinovueshme çon në ndryshime të rëndësishme në mënyrën e funksionimit të sistemit të energjisë dhe, në përputhje me rrethanat, ndikon në funksionimin e pajisjeve të mbrojtjes rele dhe automatizimit.

Një sistem konvencional i mbrojtjes ka rele me parametra fikse të vendosura. Me kompleksitetin në rritje në sistemet e operimit të energjisë, aksionet në rritje të njësive gjeneruese të energjisë të lidhura me përmbajtje pajisje elektronike, mungesën e injektimit të rrymës së qarkut të shkurtër për të zbuluar saktë defektet dhe rritjen e harmonikave që mund të shkaktojnë veprimin gabimisht të releve e mbrojtjes, linden sfida të ndryshme për të përmbushur kërkesat e mbrojtjes në kushte të ndryshueshme funksionimi. Skemat e mbrojtjes adaptive rezultojnë nga aplikimi i mikroprocesorëve në fushën e releve mbrojtëse dhe po rriten për rëndësi në sistemet e energjisë elektrike. Ato u mundësojnë operatorëve të rrjetit të kenë skema fleksibël të mbrojtjes në përgjigje të ndryshimeve në sistemin energjetik.

Në të ardhmen e afërt pritet që rrjetet e transmetimit të bëhen më komplekse dhe për këtë, përveç të tjerave, kërkohet përmirësimi dhe zotërimi i softuerit inxhinierik të aftë për të zgjidhur probleme më të ndërlikuara në të ardhmen me saktësi të lartë dhe në një kohë sa më të shkurtër.

KËRKESAT MINIMALE MBI SOFTUER-in

Aspekte të Përgjithshme

Softueri duhet të jetë sa më produktiv, i lehtë dhe me shpejtësi të shpejtë zgjidhjeje, i aftë për të punuar shumë shpejt nën kontrollin e inxhinierit specialist. Inxhinieri specialist mund të ndryshojë cilësimet e relesë dhe konfigurimin e rrjetit dhe të shohë menjëherë rezultatet e ndryshimeve të ndodhura.

Softueri duhet të ketë aftësinë për të vizualizuar mbrojtjen e rrjeteve shpejt, me saktësi dhe me lehtësi.

Për sa i përket besueshmërisë, softueri duhet të ketë një rrjet të gjerë përdoruesish kryesisht nga operatorët e transmetimit të energjisë elektrike dhe kompanitë e konsulencës në të gjithë botën, veçanërisht në Evropë dhe Amerikën e Veriut.

Aftësitë kryesore të softuerit

- Programi duhet të jetë në gjendje të kryejë Mbrojtje & Koordinim / Analizë Selektiviteti.
- Të përmabajë/plotësojë standardet e koordinimit dhe mbrojtjes ANSI/IEEE & IEC
- Të kryejë analiza të koordinimit të pajisjes Rele & Çelësave
- Modelimi i saktë i transformatorëve me 2 dhe 3 pështjella, ndërruesit e fazës (phase shifter), linjat, çelsat e fuqisë, kondensatorët në seri (me dhe pa elementë MOV jolinearë), reaktorët seri, linjat dc (përfshirë konvertuesit VSC), gjeneratorët, turbinat e erës, burimet e ndërlidhura me konvertuesit, ngarkesat, shunts dhe çiftimin reciprok me sekuencë zero.
- Modelimi i detajuar i siguresave, rikyçësive dhe releve të mbirrymës.
- Të pasurit e një baze të dhënash të redaktueshme dhe të gjerë të releve.
- Modelimi i detajuar i releve distancionale duke përdorur parametrat specifikë të markës dhe modelit dhe logjikën e funksionimit.
- Modelimi i releve diferenciale të linjës, releve të tensionit dhe skemave logjike të mbrojtjes dhe rikyçja e linjave. Mundësi për aplikimin e metodave të tjera të relesë distancionale të përcaktuara nga përdoruesi duke përdorur DLL të shkruara në C++.
- Simulimi i llojeve të mëposhtme të difekteve: difekte në nyje, defektet në fund të linjës, defektet e linjës, defektet e ndërmjetme, difekte nga nyja në nyje dhe defektet e hapjes së fazës. Opsionet e llogaritjes së para-defektit të zgjidhshme nga përdoruesi: e sheshtë (sipas parametrave nominalë), nga një zgjidhje lineare e rrjetit dhe nga një rrjedhë fuqie konkrete.
- Algoritmet e kontrollit automatik të rrjedhës së fuqisë për rregullimin e tensionit të gjeneratorit (lokal dhe në distancë), degëzimet (ancafkat) e rregullatorit të tensionit të transformatorit, kontrollorët e MW për transformatorët ndërrues të fazave (phase shifter), për aktivizimin e shunteve dhe kufizimet në rrjet në zonat ndërshkëmbore.
- Mjetet e avancuara të analizës: simulimi i ngjarjeve të shkallëzuara, përmbledhja e defekteve të ndodhura në nyje, ekuivalenca e kufirit, llogaritja e uljes të tehlla të tensionit, lokalizimin e defektit, analiza e harqeve të lidhjes së shkurtër, kontrolli i vlerësimit të çelësive dhe aspekte të tjera të ngjashme.
- Gjenerimi i raporteve të zgjidhjes së defekteve në formate teksti dhe CSV.
- Raporte gjithëpërfshirëse të cilësimeve të pajisjes me opsione filtrimi dhe renditjeje

- Kontroll automatik në të gjithë sistemin e parametrave të relesë dhe koordinimit të relesë.
- Procesim në paralel në CPU me shumë bërthama.
- Raporti i zgjidhjes së rrjedhës së energjisë nyje pas nyje me përmbledhje mbi zonat ndërkombëtare, dalja nga normat e lejuara të vlerave të tensionit, mbingarkesat e degëve, transformatorët LTC, daljet e gjeneratorit dhe ngarkesat.
- Skedarët e modelit të rrjetit të jenë kompakt dhe portativ me aftësi të integruara të menaxhimit të modelit: krahasimi i skedarëve, bashkimi 2 dhe 3-kahësh, shtimi i skedarëve, pasja e mjeteve të krijimit të rasteve.
- Kërkohej pasja e një prove besueshmërie e përdorimit të softuerit nga kompanitë elektrike dhe kompanive konsulente në Amerikën e Veriut, Evropë dhe jashtë saj, siç specifikohet më sipër.
- Pasja e mjeteve të nevojshme për të mundësuar pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në lidhje me tarimet e mbrojtjes dhe të koordinimit.
- Softueri duhet të ketë një database të gjerë të releve që përdoren në kompanitë e transmetimit të energjisë elektrike.
- Një program i plotë i rrjedhës së flukseve të fuqisë (power flow) për sistemet e transmetimit me aftësinë për të kryer studimet N-1 të kontigjencës, paraqitjen grafike të rezultateve të ngarkimit të degëve dhe të tensioneve në nyje, shkëmbimet ndërkufitare dhe humbjet e fuqisë.

Paraqitja grafike dhe opsionet e vizatimit:

- Paraqitje grafike e zgjidhjes pas ndodhjes së defektit dhe kohës së funksionimit të relesë në diagramën njëvijëshe dhe në diagramën fazore.
- Paraqitje grafike e zgjidhjes së rrjedhës së fuqisë në diagramën njëvijëshe. Paraqitje grafik në formë paralajmërimi për mbingarkesat e degëve dhe daljen nga vlerat e lejuara të tensionit.
- Ofrimi i mundësisë së përshtatjes grafike të parametrave dhe mjeteve të tjera të pajisjes
- Paraqitja automatike e karakteristikave të mbirrymës dhe relesë distancionale në ekran.
- Hartimi automatik i diagramës distancë - kohë.

Përputhshmëria e softuerit me programet e tjera dhe gjuha e programimit të tij

- Importimi i të dhënave për të dhënat e rrjetit në CIM, ANAFAS, ANAREDE, GE, PTI PSS/E, T2000 dhe formate të tjera.
- Eksportimi i të dhënave në formatet e të dhënave CIM, PTI PSS/E, ANAFAS, ANAREDE dhe GE.
- Eksportimi i të dhënave të defekteve për testimin e releve në COMTRADE, Doble dhe formate të tjera.
- Mjet i integruar i skriptimit me ndërfaqen e gjuhës së programimit BASIC.
- Moduli i ndërfaqes së programimit të aplikacionit me mbështetje për Python, C++, C# dhe mundësisht për gjuhë të tjera programimi

Kërkesat minimale harduerike dhe softuerike

Kërkesat minimale Harduerike

Softueri duhet të funksionojë në PC dhe kompjuterë të pajtueshëm me bazë Intel Pentium. Kërkesa të tjera harduerike përfshijnë:

- Një monitor me ngjyra 1024x768 ose më i mirë.
- Kujtesa: Rekomandohet 8 GB RAM.
- 300 Mb hapësirë të disponueshme në hard disk.
- Një maus me 2 ose 3 butona.
- Çdo printer ose plotter me aftësi grafike që funksionon nën Windows.

Kërkesat softuerike

- Versionet 10 dhe 11 të Microsoft Windows.

Suportimi i rrjetit

- Softueri duhet të lejojë çdo kompjuter në një rrjet lokal (LAN) të ekzekutojë programin për sa kohë që numri i ekzekutimeve të njëkohshme nuk e kalon kufirin e licencës.
- Softueri duhet të funksionojë në LAN dhe WAN me protokollin TCP/IP.

Kufizimi i madhësisë së sistemit

- Softueri nuk duhet të ketë kufi praktik në madhësinë e rrjetit që do të modelojë dhe analizojë sipas qëllimit të përdorimit të tij.

Mirëmbajtja

- Kompania duhet të sigurojë të paktën në blerjen fillestare, që softueri të vijë me 12 muaj përditësime të softuerit dhe mbështetje teknike.

Numri i Licensave

- Numri minimal i licencave të nevojshme për të përdorur këtë softuer është 3 (tre).
- Softueri duhet të funksionojë në çdo kompjuter desktop ose laptop që ka akses te çelësi i licencës ose lokalisht në portën USB të makinës (dongle) ose përmes rrjetit në një makineri të dedikuar të serverit të licencës (çelësi i rrjetit).

Gjuha Softuerit

- Gjuha e ndërtimit (komandat, dritaret dialoguese,etj) të softuerit duhet të jetë në gjuhën angleze.

Trajnim bazë

- Kompania duhet të sigurojë një trajnim bazik të përdorimit të softuerit.

REFERENCAT

- *KODI SHQIPTAR I TRANSMETIMIT* (http://ere.gov.al/doc/KODI_I_TRANSMETIMIT-1.pdf)
- *UDHEZIMI I ENTSO-E: TECHNICAL BACKGROUND AND RECOMMENDATIONS FOR DEFENCE PLANS IN THE CONTINENTAL EUROPE SYNCHRONOUS AREA*(https://eepublicdownloads.entsoe.eu/cleandocuments/pre2015/publications/entsoe/RG_SOC_CE/RG_CE_ENTSO-E_Defence_Plan_final_2011_public_110131.pdf)
- *STANDARTET IEC 60255-1xx*

Introduction and Main Background

This terms of reference (TOR) defines the minimal requirements and other conditions required for procurement of a power system protection software for relay selectivity and coordination of a power transmission network.

Network protection is key to mitigate the risks in an interconnected power system and enhance the reliability of the power supply while contributing to the resilience of the system itself. Proper protection equipment modeling is an essential task for the power engineer.

Transmission Network is administered by Transmission System Operator of OST sh.a, which is licensed for carrying out of legal activity of power transmission via mains high voltage (110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV). Assets managed by OST sh.a are:

- All 400, 220, 150 and 110 kV lines including switching devices and their installations.
- 400/220/110 kV substations; 400/220 kV; 400/110 kV; 220/110/TM kV; 220/MV kV and 110/MV busbars of Distribution Operator, up to the metering point at the 110 kV power transformers 110 / MV of Distribution Operator substations.
- 220 kV substations of HHP's V.Dejes, Koman and Fierze except 220 kV generators outputs, up to 220 KV busbar breakers, 110 kV / 150 kV including 150 kV output of the overhead line and 110/150 kV step up transformer in Bistrica 1 Hydropower Substation.

Albania's transmission network operates by maintaining and continuously improving its performance, especially in terms of security and quality of supply for all his customers. It remains a permanent task of the operator of this System to plan and implement measures in different terms of time, to improve its condition towards maintaining and further achieving the standards. Also, OST is a full member of ENTSO-E (European association for the cooperation of transmission system operators (TSOs) for electricity), since 2017 and has the obligation to fulfill the rules and standards that this organization contains and the harmonization of the European legal framework in the field of energy

In this context, a lot of work remains to be done in different directions in the power transmission grid, in order to ensure the appropriate interventions, which will lead to the necessary improvements in all elements of the network.

One of the necessary and current directions in which it is necessary to intervene is the need for certain, but acute, improvements in the relay protection system.

OST is responsible for setting of relay protection throughout the Transmission System Network 400 kV, 220 kV, 150 kV, and 110 kV. OST approves relay protection system and set the settings to network elements in coordination with Transmission network Users. Transmission network Users by them, are responsible for settings of Relay Protection of their network, systems/objects and shall coordinate the settings of Relay Protection in these installations and equipment on the property boundary with Transmission System Network.

A reliable electric system requires proper protection and control coordination between power plants and the transmission system.

Coordination of generation and transmission protection systems (for events external to the plant), means that power plant protection and related control elements must be set and configured to prevent unnecessarily tripping the generator prior to any transmission protection and related control systems acting first, unless the generator is in jeopardy by exceeding its design limits due to operating conditions, generator system faults, or other adverse potentially damaging conditions.

OST may advise modifications and improvements of relay protection in the distribution system, in order to reduce the negative impacts on the transmission system.

The need to conduct a comprehensive study of the coordination and selectivity of protection for the 110kV, 220kV and 400kV network, including all substations and component lines, as well as proposals for the possibility of improving the relay protection system is a necessary task.

The purpose of the analysis of the coordination and selectivity of protection in the high voltage network, so that the protection devices isolate and eliminate the fault quickly and selectively.

Protection coordination means selecting and setting of protective devices so that they are sensitive enough to operate when needed, and selective enough to not operate, or provide adequate margin, when not needed.

The protection coordination study or security assessment must consider the network topology, network elements, different operating conditions, utility practices and regulatory requirements.

According to the national energy strategy 2018÷2030 of the country, Albania has set targets for the energy efficiency such as reducing greenhouse gases, diversification of renewable sources, increasing the penetration of natural gas, etc.

In the framework of the policy of diversification of electricity in the country, especially in recent years, there has been a high number of requests for the connection of the renewable energy sources (RES) in the transmission network. Mostly these are solar and wind power plants. The penetration of renewable energy leads to significant changes in the operating mode of the power system and, accordingly, affects the functioning of the relay protection and automation devices.

A conventional protection system has relays with fixed setting parameters. With the growing complexity in operating power systems, the increasing shares of power electronic connected generating units, a lack of short circuit current injection to correctly detect faults, and increased harmonics that can falsely trigger protection relays, various challenges arise to fulfil the protection requirements in variable operation conditions. Adaptive protection schemes result from the application of microprocessors in the area of protective relays and are growing in importance in the electrical power systems. They enable grid operators to have flexible protection schemes in response to changes in the power system.

In the near future, it is expected that transmission networks will become more complex, and for this, in addition to others, it is required to improve and possess engineering software capable of solving more complicated problems in the future with high accuracy and in a shorter time.

SOFTWARE MINIMAL REQUIREMENTS

General Aspects

The software must be a productive, light and fast solution speed software, able to work very quickly under the control of the specialist engineer. The specialist engineer can change the relay settings and network configuration and see the results of the change immediately.

The software must have the capability to visualize the protection of the networks quickly and easily.

In terms of reliability, the software should have a wide network of users mainly from transmission power utilities and consulting companies all over the world, especially in Europe and North America.

Main capabilities of the software

- The program must be able to perform Protection & Coordination / Selectivity Analysis.
- ANSI/IEEE & IEC coordination & protection standards
- Relay & Breaker device coordination analysis
- Accurate modeling of 2- and 3-winding transformers, phase shifters, lines, switches, series capacitors (with and without nonlinear MOV elements), series reactors, dc lines (including VSC converters), generators, wind turbines, converter interfaced resources, loads, shunts and zero-sequence mutual coupling.
- Detailed modeling of fuses, reclosers and overcurrent relays.
- An editable and extensive relay library.
- Detailed modeling of distance relays using make and model-specific parameters and operating logic.
- Modeling of line differential relays, voltage relays and protection logic schemes and reclosing of lines. User-defined distance-relay methods using DLLs written in C++.
- Simulation of the following fault types: bus faults, line-end, line-out, intermediate faults, bus-to-bus fault, and phase-open faults. User-selectable pre-fault calculation options: flat, from a linear network solution, and from a power flow.
- Power flow automatic-control algorithms for generator voltage regulation (local and remote), transformer load tap changers, phase shifter MW controllers, switched shunts, and area-interchange constraints.
- Advanced analysis tools: stepped-event simulation, bus fault summary, boundary equivalence, voltage sag calculation, fault location, arc-flash analysis, breaker rating checking, and more.
- Generation of fault solution reports in text and CSV formats.
- Comprehensive device settings reports with filtering & sorting options
- Automatic system-wide checking of relay parameters and relay coordination.
- Parallel processing on multi-core CPU.
- Bus-by-bus power flow solution report with summaries on area interchange, voltage violations, branch overloads, LTC transformers, generator outputs, and loads.
- Compact and portable network model files with built-in model management capabilities: file comparison, 2-way and 3-way merge, add files, case builder tools.
- Required a proven reliability of usage of electric utilities and consulting companies in the North America, Europe and abroad as specified above.
- Tools for compliance with international standards regarding protection settings and coordination.
- The software should have a wide database of relays used in electricity transmission companies.
- A complete power flow program for transmission systems with the ability to perform N-1 contingency studies, graphical representation of branch load results and node voltages, cross-boundary exchanges and power losses power.

Graphical representation and plotting options:

- Graphical display of post-fault solution and relay operating time on the one-line diagram and on phasor diagrams.

-
- Graphical display of power flow solution on the one-line diagram. Graphical warning of branch overloads and voltage violations.
 - Graphically adjustable device settings & tools
 - Automatic plotting of overcurrent and distance relay characteristics on the screen.
 - Automatic plotting of time-distance diagram.

Software compatibility and programming language

- Data importing for network data in CIM, ANAFAS, ANAREDE, GE, PTI PSS/E, T2000 and other formats.
- Data exporting in CIM, PTI PSS/E, ANAFAS, ANAREDE and GE data formats.
- Exporting of fault data for relay testing in COMTRADE, Doble, and other formats.
- Built-in scripting tool with BASIC programming language interface.
- Application Programming Interface module with supports for Python, C++, C#, and other programming languages

Hardware and Software requirements

Hardware Requirements

The software must run on Intel Pentium-based PCs and compatibles. Other hardware requirements include:

- A 1024x768 or better color monitor.
- Memory: 8 GBytes of RAM is recommended.
- 300 Mb of available hard-disk space.
- A 2- or 3-button mouse.
- Any graphics-capable printer or plotter that works under Windows.

Software Requirements

Microsoft Windows 10 and 11.

Network Support

- The software must let any PC on a local area network (LAN) execute the program as long as the number of simultaneous executions does not exceed the license limit.
- The software must work in LANs and WANs with the TCP/IP protocol.

System size Limitation

- The software must have no practical limit on network size.

Maintenance

- The company must provide at least on initial purchase, that the software comes with 12 months of software updates and technical support.

Number of Licenses

- The minimum number of licenses required to use this software is 3 (three).
- The software must run in any desktop PC or laptop that has access to the license key either locally on the machine usb port (dongle) or over the network on a dedicated license server machine (network key).

Software Language

- The language of construction (commands, dialogue windows, etc.) of the software must be in English.

Training

- The company must provide a basic training in the use of the software.

REFERENCES

- *ALBANIAN TRANSMISSION CODE* (https://www.ost.al/wp-content/uploads/2022/04/Transmission_Network_Code_14.06.2018.cleaned.pdf)
- *TECHNICAL BACKGROUND AND RECOMMENDATIONS FOR DEFENCE PLANS IN THE CONTINENTAL EUROPE SYNCHRONOUS AREA BY ENSTO-E* (https://eepublicdownloads.entsoe.eu/clean-documents/pre2015/publications/entsoe/RG_SOC_CE/RG_CE_ENTSO-E_Defence_Plan_final_2011_public_110131.pdf)
- *IEC 60255-1XX STANDARDS*

Shënime:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku është cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: Sipas Specifikimeve Teknike (Shtojca 5) dhe Listes së Cmimeve (Shtojca 2)

Afatet e lëvrimit: 13 (trembedhete) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates:

Nr.	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Blerje program (software) për kryerjen e tarimeve, koordinimit dhe selektivitetit të mbrojtjes rele për rrjetin e transmetimit, si dhe trajnim të punonjësve	1	OST sh.a.	1 (nje) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates
2	Mirëmbajtja e softuerit	1	OST sh.a.	12 (dymbedhete) muaj pas dorezimit te programit software

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 30,000,000 (tridhjetë milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 13,000,000 (njemdhjetë milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të

deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shenim: Lidhur me mirembajtjen e softit objekt prokurimi, kontrata të ngjashme do të konsiderohen mirembajtjet e softëve të ngjashme të integruara ose kompatibel me sisteme energjitike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për të gjitha mallrat objekt prokurimi. Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit, duhet të jenë të përthyerë në gjuhën shqipe dhe të tregojnë lehtësisht dhe se cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të pakten 1(nje) punonjës të pajisur me certifikate për trajnim për modulet e mbrojtjes, ose të ketë suportin nga prodhues softesh të ngjashëm, për një punonjës të tillë.

Ky kriter mund të plotësohet në dy mënyra:

- i. Të jetë pjesë e stafit të OE ofertues dhe për këtë duhet të disponohet listpagesa e fundit ku të përshihet punonjësi i sipërcituar, kontratën e punës, si dhe certifikimin përkatës.
